



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

---

## RAPORT

### I

## MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS PËR VIZITËN NË QENDRËN E PARABURGIMIT NË PRIZREN

**Për:** Znj. Albulena Haxhiu, ministre  
Ministria e Drejtësisë

**Kopje:** Znj. Duda Balje, kryetare  
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe  
Peticione

Z. Habit Hajredinaj, drejtor  
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Z. Ali Gashi, ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Milazim Gjocaj, drejtor  
Departamenti për Shëndetësinë në Burgje

Z. Eset Loku, drejtor  
Qendra e Paraburgimit në Prizren

Prishtinë, 1 dhjetor 2021

## HYRJE

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (në vijim: MKPT), bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social. Më 19 tetor 2021, MKPT-ja vizitoi Qendrën e Paraburgimit në Prizren (më tej: QPP).

Sipas njoftimit në ueb-faqen e Shërbimit Korrektues të Kosovës (në vijim: ShKK)<sup>1</sup>, në QPP vendosen të paraburgosurit dhe të dënuarit me dënime deri në tre muaj. Kapacitetit zyrtar i QPP-së është për 92 persona, ndërsa, në kohën e vizitës në QPP, ishin të vendosur 76 të burgosur, prej tyre 60 të paraburgosur dhe 16 të dënuar.

### Qëllimi i vizitës

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të të burgosurve.

### Bashkëpunimi i QPP-së me MKPT-në gjatë vizitës

Gjatë vizitës së MKPT-së në QPP, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (në vijim referuar si: DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje të papenguar në të gjitha vendet e vizituara dhe iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën, si dhe iu mundësuan bisedat me personat e dënuar dhe të të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe pa praninë e personelit shëndetësor.

### Informimi për të drejtat e të burgosurve

1. Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese (më tej: Rendi Shtëpiak) përcakton obligimet e institucioneve korrektuese që, menjëherë pas pranimit, të sigurojnë kushte që i burgosuri të informohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet e tij.
2. Më tej Rendi Shtëpiak përcakton se Rendi Shtëpiak dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (më tej: LESP) janë në dispozicion të të burgosurve gjatë gjithë kohës. I burgosuri, i cili nuk di shkrim dhe lexim, njoftohet gojarisht për të drejtat dhe për obligimet.<sup>2</sup> Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua se të burgosurit njoftohen për të drejtat dhe për obligimet e tyre me rastin e pranimit në QPP. MKPT-ja po ashtu ka vërejtur se në të gjitha hapësirat e QPP-së janë të vendosura informatat zyrtare lidhur me pandeminë COVID-19, si dhe informata për ndihmë juridike falas.

### Keqtrajtimi fizik

3. MKPT-ja gjatë vizitës në QPP intervistoi një numër të të burgosurve dhe nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike të ushtruar nga zyrtarët korrektues apo për sjellje të autoriteteve të burgut, të cilat do të përbënin shkelje të dinjitetit të të burgosurve. Përveç kësaj, MKPT-ja vërejti se ekziston një klimë pozitive

<sup>1</sup> <https://shkk.rks-gov.net/institucionet-single/2233>.

<sup>2</sup> Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 20.

e marrëdhënieve dhe komunikim i mirë interaktiv ndërmjet të dënuarve dhe zyrtarëve korrektues.

4. MKPT-ja mori një ankesë nga V. K. për keqtrajtim nga zyrtarët policorë të Kosovës gjatë arrestimit. Lidhur me këto pretendime, MKPT-ja kontrolloi dosjet mjekësore të ankuesve në të cilat nuk u gjeten dëshmi lidhur me pretendimet në fjalë. Sidoqoftë, ankuesit u njoftuan nga MKPT-ja për të drejtën e tyre për të parashtruar ankesë në Inspektoratin Policor të Kosovës lidhur me pretendimet për keqtrajtim nga policia.

### **Kushtet e akomodimit**

5. LESP-ja shprehimisht përcakton se i dënuari ka të drejtë për strehim, i cili u përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike.<sup>3</sup> Më tej ligji përcakton: *“Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta. dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.”*<sup>4</sup>
6. MKPT-ja gjatë vizitës vërejti se qelitë ku qëndronin të paraburgosurit kishin ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial dhe nuk kishin lagështi. Sa i përket hapësirës për banim për të burgosurit, MKPT-ja, sikurse edhe në raportin e mëhershëm me rekomandime, konstaton se hapësira për banim, në disa qeli, nuk është në pajtim me dispozitat e LESP-së dhe as me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (më tej: KPT).<sup>5</sup>
7. **MKPT-ja ka vërejtur se jo të gjitha qelitë janë furnizuar me dyshekë të rinj.** Kështu që, në disa qeli dyshekët janë të vjetërsuar dhe nuk janë ndërruar për kohë të gjatë dhe për pasojë, në disa shtretër ka depërtuar lagështia. MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga të burgosurit për mungesë të mjeteve higjienike dhe materialeve kundër COVID-19. Në QPP, të paraburgosurit mund të bëjnë dush dy herë brenda javës, ndërsa të dënuarit nuk kanë kufizime.
8. **MKPT-ja mori ankesa nga disa shtetas të huaj për mungesë të veshmbathjeve.** Po ashtu, MKPT-ja mori pohimet e disa shtetasve të huaj të cilët praktikojnë fenë islame se për shkak të mungesës së rrobave adekuate, ata nuk janë në gjendje të kryejnë faljen e namazit sipas dispozitave fetare islame. Në këtë drejtim, MKPT-ja vëren se neni 41, paragrafi 1, i LESP-së shprehimisht përcakton: *“Personi i dënuar ka të drejtë në ndërresa, rroba dhe këpuca pa pagesë, të përshtatshme për kushtet vendore klimatike dhe stinën e vitit.”*
9. Po ashtu, Udhëzimi Administrativ MD-NR.07/20151 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, në nenin 18 përcakton se i burgosuri i cili nuk i ka ndërresat, rrobat dhe këpucët e veta, i sigurohen ndërresat, rrobat dhe këpucët të cilat duhet t'u përgjigjen kushteve klimatike dhe stinës së vitit. MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të veprojnë në pajtim me dispozitat e lartpërmendura.

<sup>3</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 1.

<sup>4</sup> Ligji nr. 05/L0-129, neni 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

<sup>5</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449/>

## Mbipopullimi

10. Kapaciteti zyrtar i QPP-së është për 92 persona, ndërsa gjatë vizitës së MKPT-së ishin të akomoduar 76 të burgosur. MKPT-ja gjatë vizitës vërejti se nuk ka mbipopullim në QPP.

## Ushqimi

11. LESP-ja përcakton të drejtën e të burgosurve për ushqim të përshtatshëm, për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tyre, tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojllojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'u përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, aq sa është e mundur, kërkesave të tij fetare dhe kulturore.<sup>6</sup>
12. Më tej ligji përcakton se personi i dënuar, i cili kryen punë të rënda, personi i sëmurë, gruaja shtatzënë, ose ajo e cila ka lindur fëmijë, kanë të drejtë për ushqim të caktuar nga mjeku edhe për ushqim dietal.<sup>7</sup> Mjeku, ose eksperti tjetër për ushqim, e kontrollon ushqimin dhe, para shërbimit të çdo shujte, e njofton drejtorin e institucionit korrektues për cilësinë e ushqimit dhe konstatimet e tij i shënohen në librin përkatës.<sup>8</sup>
13. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti se kushtet higjienike në kuzhinë ishin në nivelin e duhur dhe kuzhina ishte e pajisur me pajisjet e nevojshme për ta kryer punën në përgatitjen e ushqimit, të cilat ishin të vjetërsuara por të mirëmbajtura. Përveç tri shujtave ditore, në dispozicion të të burgosurve është edhe ushqimi dietal, i cili jepet sipas rekomandimit të mjekut.
14. Stafit i kuzhinës ishte i pajisur me libreza sanitare. Përveç stafit, të pajisur me libreza sanitare ishin edhe të dënuarit e angazhuar në punë. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga të burgosurit sa u përket sasisë dhe kualitetit të ushqimit që u shërbehet. **MKPT-ja ka vërejtur se të angazhuarit në punë në kuzhinë nuk kanë veshje adekuate. MKPT-ja konsideron se duhet të ndërmerren hapat e nevojshëm për ta mënjanuar këtë mangësi.**

## Regjimi

15. Në QPP, 11 të dënuar janë të angazhuar në punë. Mementalisht të dënuarit angazhohen në punë për pastrim, në kuzhinë dhe për mirëmbajtje të caktuara të objektit. Të dënuarit kanë mundësi të dalin në shëtitje gjatë gjithë kohës, dyert i kanë të hapura prej orës 7:00 të mëngjesit deri në orën 19:00 në mbrëmje.
16. Gjatë vizitës, disa të burgosur pohuan se të burgosurit e sapopranuar vendosen në karantinë për 7 ditë dhe dalin në shëtitje 15 minuta paradite dhe 15 minuta pasdite. Meqenëse LESP-ja garanton që i burgosuri të ketë së paku dy orë ajrim brenda ditës, MKPT-ja mirëpret komentet e QPP-së lidhur me këtë kufizim të kohës së ajrimit.
17. Infrastruktura e burgut nuk lejon që të zhvillohen aktivitete të ndryshme, të cilat parashihen me LESP. Përpos shëtitjes, ata kanë në dispozicion një tavolinë ping-pongu, lojën e shahut dhe letra domino. TV-të ishin funksionale dhe tani QPP-ja kishte instaluar sistemin kabllor të TV-së. **Gjatë vizitës, MKPT-ja mori ankesa nga disa të burgosur,**

<sup>6</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 1.

<sup>7</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 2.

<sup>8</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 3.

**për shkak të mungesës së më shumë titujve të librave në bibliotekë dhe mungesës së kopjeve të librit të shenjtë të myslimanëve (Kuranit).**

18. Në rastin e të paraburgosurve, angazhimi i tyre në punë varet nga leja e gjykatës. MKPT-ja vëren se sa i përket angazhimit në punë të të paraburgosurit, neni 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t’i lejohet të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit.”*
19. Ndërsa neni 200, paragrafi 1, i LESP-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë, përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektues përkatës pas marrjes së pëlqimit të gjykatës kompetente.”*
20. MKPT-ja konsideron se bazuar në legjislacionin në fuqi, autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje që të rriten angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit jo vetëm në QPP, por edhe në qendrat e tjera të paraburgimit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.

### **Kujdesi shëndetësor**

21. Neni 43 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë për shërbime shëndetësore pa pagesë. Personi i dënuar, të cilit nuk mund t’i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues, dërgohet në spitalin e burgut, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjetër, për përkujdesje shëndetësore.<sup>9</sup>
22. Në përbërje të njësisë shëndetësore në QPP është një mjekë e rregullt, e cila punon me orar të plotë. Përveç mjekes, janë edhe 5 infermierë të rregullt, 4 infermierë punojnë me ndërrime nga 12 orë, kurse kryeinfermierja punon me orar nga 08.00-16.00, një psikologe e rregullt me orar 08:00 -16:00, një psikiatër i rregullt me gjysmë orari (4 orë). Ndërsa sa u përket shërbimeve stomatologjike, ato ofrohen një herë në javë nga stomatologu i Qendrës Korrektuese në Lipjan.
23. Po ashtu, radiologu është në dispozicion dy herë në muaj, ndërsa për sëmundje të tjera dhe konsultime dërgohen në Spitalin Regional të Prizrenit, si dhe në ShSKUK në Prishtinë. MKPT-ja u njoftua gjatë vizitës se në Spitalin Regional të Prizrenit, në dispozicion të QPP-së është një dhomë e veçantë për t’i akomoduar të burgosurit. Terapia ndahet nga stafi shëndetësor sipas nevojë, me ç’ rast pranohen edhe kërkesat nga të burgosurit për t’u kontrolluar të mjeku.
24. Sa i përket infrastrukturës ku ofrohen shërbimet mjekësore, MKPT-ja gjatë vizitës vërejtë se në dispozicion të njësisë shëndetësore është një dhomë ku kryhen të gjitha shërbimet shëndetësore, si: shërbimet e infermierisë, ku kryhen intervenimet e ndryshme; po ashtu mjeku kryen shërbimet shëndetësore, si dhe bëhen konsultimet nga specialistët e tjerë në raste nevojë.

<sup>9</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 43, par. 2.

25. MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se detektori i vendosur në hyrje të pavijoneve mund të përbëjë pengesë serioze për personelin shëndetësor për të reaguar në raste emergjente pasi përfshin një hapësirë të madhe dhe mund të përbejë problem serioze në raste të nevojës për të transportuar të burgosurin jashtë pavijonit. MKPT-ja mirëpret komentet e DShB-së dhe të drejtorit të QPP-së lidhur me këtë vrojtim.
26. Tani në dispozicion të psikologut është dhoma e veçantë për t'i realizuar seancat psikologjike. Prania e të burgosurve me sëmundje mendore vazhdon të jetë sfidë për qendrat e paraburgimit dhe për ato korrektuese. Gjatë vizitës MKPT-ja vërejtë se ishin mbi 10 raste me terapi psikiatrike.

### **Rëndësia e kontrolleve mjekësore për të burgosurit e sapopranuar**

27. LESP-ja<sup>10</sup> dhe Praktika Standarde e Veprimeve (më tej: PSV)<sup>11</sup> e DShB-së përcaktojnë obligimin që i burgosuri i sapopranuar t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda 24 orësh nga momenti i pranimit.
28. Bazuar në pohimet e të burgosurve dhe në dokumentacionin relevant, të sapopranuarit, brenda 24 orësh, u nënshtrohen kontrolleve mjekësore, në pajtim me LESP-në dhe me PSV-në e DShB-së.

### **Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore**

29. Sa i përket konfidencialitetit të shërbimeve mjekësore, MKPT-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe me personelin shëndetësor, konstaton se këto shërbime jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përveç në raste kur prania e tyre kërkohet nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.

### **Masat disiplinore**

30. Sipas legjisllacionit në fuqi, dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve, janë: Qortimi, heqja e beneficionit të caktuar; urdhri për kompensim dhe vetmia.<sup>12</sup> Kurse në rastin e të paraburgosurve, mund të shqiptohen dënimet, si në vijim: Kufizimi apo ndalimi i vizitave apo i korrespondencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, me Avokatin e Popullit dhe me misionet diplomatike. Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua nga drejtori se në QPP nuk aplikohet masa disiplinore e vetmisë. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit lidhur me shqiptimin e masave disiplinore nga drejtori i QPP-së.

### **Kontakti me botën e jashtme**

31. MKPT-ja konsideron se kontaktet me botën e jashtme, veçanërisht vizitat nga familja apo nga të afërmit e tjerë, janë të rëndësishme thelbësore në kontekstin e rehabilitimit social të të burgosurve.
32. Legjisllacioni në fuqi,<sup>13</sup> për rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespondencë (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe kanë të drejtë për një vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj.

<sup>10</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31.

<sup>11</sup> Praktika Standarde e Veprimeve, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf/>

<sup>12</sup> Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

<sup>13</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Sipas drejtorit të QPP-së, të burgosurit kanë të drejtë për një vizitë në javë. Vizitat në rastin e të paraburgosurve autorizohen nga gjykata kompetente.

33. Sa u përket thirrjeve telefonike, neni 60 i LESP-së përcakton se i dënuari ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike. Në rastet e të paraburgosurve, këto telefonata autorizohen nga gjykata kompetente. Bazuar në informatat e siguruar nga drejtori i QPP-së dhe nga pohimet e të paraburgosurve, atyre u lejohen dy telefonata në javë, të cilat janë subjekt i lejes së gjykatës kompetente. Ndërsa në rastet e të dënuarve nuk ka kufizime.
34. MKPT-ja mori ankesa nga shtetasit e huaj se nuk e gëzojnë të drejtën për të kontaktuar me familjet e tyre, për shkak se nuk u lejohet të kontaktojnë me familjet e tyre përmes SKYPE. Lidhur me këto pohime, drejtori i QPP-së pohoi se për shkak të lirimit të masave të kufizimit kundër pandemisë COVID-19, SKYPE më nuk mund të përdoret. Megjithatë, sipas ankuesve, linjat telefonike me vendet e tyre të origjinës nuk funksionojnë.
35. Po ashtu, MKPT-ja gjatë vizitës, bazuar në ankesën e një shtetasi gjerman, i rekomandoi drejtorit të QPP-së që ta njoftojë ambasadën apo konsullatën e shtetit të tij, pasi ky obligim përcaktohet me LESP, neni 33, paragrafi 1, i cili shprehimisht përcakton: *“Institucioni korrektues i mundëson personit të dënuar kontakt të menjëhershëm me anëtarët e familjes pas pranimit të tij. Shtetasit të huaj i ofrohet mundësia që me shkrim, ose me telefon ta kontaktojë përfaqësuesin diplomatik, apo zyrën përkatëse të shtetit, shtetësinë e të cilit e ka ai.”*

#### **Procedura e parashtrimit të ankesave**

36. Neni 91 i LESP-së përcakton në hollësi procedurën, sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe ministri i Drejtësisë.<sup>14</sup>
37. MKPT-ja vërejtë se në dispozicion të të burgosurve në QPP gjenden kutitë e ankesave, të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe ato të DShB-së. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.
38. Po ashtu, ata mund t'i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit edhe përmes linjës telefonike pa pagesë (informatat për linjën telefonike janë të vendosura në kutitë e ankesave), përmes postës së rregullt, e cila, sipas LESP-së, nuk i nënshtrohet kontrollit nëse i adresohet Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, si dhe përmes familjarëve të tyre.
39. Në rastin e shtetasve të huaj, LESP-ja përcakton të drejtën e shtetasit të huaj për të kontaktuar dhe mbajtur korrespondencë me ambasadën apo konsullatën e shtetit të tij.<sup>15</sup>

---

<sup>14</sup> Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: *“Në ankimin e paraqitur, drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën e shkruar.”*

<sup>15</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 33 dhe 57.



40. MKPT-ja vërejtë se të burgosurve në QPP u ofrohet mundësia adekuate për parashtrim të ankesave dhe të kërkesave. Ky institucion i shqyrton ato dhe u dërgon përgjigje të burgosurve në këtë qendër, në pajtim me LESP-në. Po ashtu, QPP-ja i regjistron të gjitha ankesat dhe kërkesat e të burgosurve në dosjet e tyre administrative. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit, sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë.

#### **Personeli i QPP-së dhe çështje të ndërlidhura me sigurinë**

41. Sa i përket rekomandimit të MKPT-së për përmirësim të kushteve të punës së zyrtarëve korrektues, gjendja mbetet e njëjtë. **Përveç kushteve të punës, zyrtarët korrektues përballen edhe me mungesa të uniformave dhe të pajisjeve të tjera.** Në përgjithësi, hapësirat e QPP-së janë të pajisura me kamera të sigurisë dhe shumica e tyre janë funksionale, të cilat, për nga pikëpamja e MKPT-së dhe e KPT-së, përbëjnë garanci shtesë kundër keqtrajtimit fizik dhe kundër akuzave eventuale të rrejshme ndaj zyrtarëve korrektues.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKPT-së gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

#### **REKOMANDON**

##### **Ministrisë së Drejtësisë:**

- **Të burgosurit, sipas nevojës, të furnizohen me veshmbathje (shiko paragrafin 8 të raportit).**
- **Të angazhuarit në punë në kuzhinë të furnizohen me veshje të përshtatshme (shiko paragrafin 14 të raportit).**
- **Të shtohen aktivitetet jashtë qelisë për të paraburgosurit, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale dhe me LESP-në dhe për aq sa një gjë e tillë është e mundur në QPP.**
- **QPP-ja të furnizohet në tërësi me dyshekë të rinj dhe cilësorë.**
- **Të krijohen kushte adekuate pune për personelin korrektues, të furnizohen me uniforma dhe me pajisje pune të nevojshme.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit